



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

---

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe Veterinarisë

**Departamenti:** Agroekonomi

**Programi:** Ekonomi e Bujqësisë dhe Ushqimit

## NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Blenda Fazliu, me titull:

**“Analizimi i zinxhirit të vlerës nga fermeri te konsumatori në sektorin e mjaltit”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë, nga datë 16 deri me datë 22.09.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asis. Dr. Iliriana Miftari – kryetar,
2. Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra – anëtar,
3. Prof. Asoc. Dr. Arbenita Hasani – anëtar.

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asis. Dr. Iliriana Miftari, përmes e-mail adresës [iliriana.miftari@uni-pr.edu](mailto:iliriana.miftari@uni-pr.edu).

Për të pasur një informacion paraprak, më poshtë gjeni një përmbledhje të shkurtër të temës në fjalë.

Çdo sygjërim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë!

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**  
**DEPARTAMENTI AGROEKONOMI**  
**PROGRAMI EKONOMI E BUJQËSISË DHE USHQIMIT**



**Tema:**

**“Analizimi i zinxhirit të vlerës nga fermeri te konsumatori në sektorin e mjaltit”**

**Mentor:**

Prof. Asis. Dr. Iliriana Miftari

**Kandidati:**

BSc. Blenda Fazliu

Prishtinë, 2024

## PËRMBLEDHJE

Prodhimi i mjaltit në Kosovë është një sektor me potencial të lartë për zhvillim. Megjithatë, ky sektor përballlet me sfida dhe kufizime. Kërkimi për të kuptuar zinxhirin e vlerës së mjaltit në Kosovë synon të analizojë rolin e të gjithë akterëve të përfshirë, duke identifikuar mundësitë dhe kufizimet kryesore. Hipotezat e punimit theksojnë ndërveprimin midis konsumatorëve, fermerëve dhe politikave qeveritare në formimin dhe zhvillimin e sektorit të mjaltit në Kosovë. Përmes analizave kualitative dhe sasiore të të dhënave të mbledhura, synohet të arrihet një kuptim më i thellë i sfidave dhe mundësive për zhvillimin e sektorit të mjaltit në Kosovë, duke propozuar rekomandime për përmirësimin e integritit dhe funksionimit të zinxhirit të vlerës.

Studimi analizon potencialin dhe sfidat e sektorit të mjaltit në Kosovë, me fokus në identifikimin e mundësive dhe kufizimeve në zinxhirin e vlerës. Përmes një kombinimi të të dhënave primare dhe sekondare, përdorimit të pyetësorëve dhe analizave statistikore është mundur një kuptim më i thellë i rrjedhës së mjaltit në tregun kosovar. Rezultatet e hulumtimit theksojnë sfidat e fermerëve në përballje me teknologjitë moderne, si dhe mundësitë për të rritur specializimin dhe efikasitetin në prodhim. Politikat dhe praktikat qeveritare, si dhe preferencat e konsumatorëve, janë gjithashtu analizuar për të kuptuar impaktin e tyre në zhvillimin e sektorit të mjaltit. Rekomandimet për përmirësim përfshijnë trajnime të avancuara për fermerët, politika mbështetëse për integrimin e zinxhirit të vlerës dhe rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve. Kjo analizë kontribuon në zgjerimin e njohurive për sektorin e mjaltit në Kosovë dhe ofron udhëzime për zhvillimin e një industrie të qëndrueshme dhe inovative.

**Fjalët kyçe:** *Mjalti, zinxhiri i vlerës, Kosova, fermerët, zhvillim bujqësor.*